

GJYKATA THEMELORE NË PEJË
DEGA DEÇAN

C. nr. 250/11

GJYKATA THEMELORE NË PEJË, DEGA NË DEÇAN, përmes gjyqtares së EULEX-it Franciska Fiser, duke vepruar sipas vendimit të Gjyqtarit të EULEX-it i deleguar nga Kryetari i Asamblesë së gjyqtarëve të EULEX-it, me datë 11 Dhjetori 2012, në rastin civil të paditëses ML nga Deçanit rr. "Luan Haradinaj" pn, përfaqësuar nga avokat QF nga Deçani kundër të paditurit HL nga Deçani, rr. "Luan Haradinaj" pn, përfaqësuar nga avokati HC nga Deçani, në ndarjen e pasurisë së përbashkët martesore, pas seancës kryesore gjyqësore të mbajtur më 20 Maj 2013, lëshon si në vijim;

A K T G J Y K I M:

I.

Është VËRTETUAR se paditësja ML, e lindur me 12 Qershor 1951, nga Deçani, Rr. "Luan Haradinaj" pn. është pronare e pjesës ideale prej $\frac{1}{2}$ e një pasurie të patundshme:

- ngastra kadastrale nr. 01161-0, që ndodhet në Deçan në vendin e quajtur "Mareshali Tito-Fshati", regjistruar në listën poseduese nr. 00246 Zona Kadastrale Deçan, e një sipërfaqeje të përgjithshme prej 589 m²;
- ngastra kadastrale nr. 00295-0, që ndodhet në Deçan në vendin e quajtur "Gogishte-Seishta", regjistruar në listën poseduese nr. 00246 Zona Kadastrale Deçan, e një sipërfaqeje 1770 m²;
- ngastra kadastrale nr. 00001-0, regjistruar në listën poseduese nr. 00136 Zona Kadastrale Prilep, me një sipërfaqe prej 6304 m² dhe,
- ngastra kadastrale nr. 00002-0, regjistruar në listën poseduese nr. 00136 Zona Kadastrale Prilep, me një sipërfaqe prej 12601 m².

II.

I Padituri urdhërohet që t'i paguajë paditësit shumën prej 970,32 euro në lidhje me kostot procedurale, brenda periudhës prej 15 ditësh pas pranimit të këtij vendimi, nën kërcënimin e përmbarimit.

III.

Pjesa tjetër ose kërkesë padia tjetër **REFUZOHET** si e pabazuar.

A r s y e t i m i :

Paditësi ka parashtruar një padi në Gjykatën Komunale në Deçan, me datë 20 Korrik 2011 kundër të paditurës për shkak të ndarjes së pasurisë së përbashkët martesore. Ajo ka pretenduar në padinë e saj se ajo dhe i padituri u martuan më 12 Maj 1972 dhe ata kanë katër fëmijë nga kjo martesë. Marrëdhënia martesore zgjati deri në 14 Gusht 1996, kur martesja e tyre u shpërbë.

Gjatë martesës së tyre, palët nëpërmjet përpjekjeve të përbashkëta dhe të punës, kishin blerë disa pasuri të paluajtshme në disa lokacione të caktuara në disa vende, d.m.th, në fshatin Prilep dhe në vende të caktuara në Deçan.

Një pjesë e tokës e përbërë nga 0.16,76 ha lista poseduese nr. 604 Zona Kadastrale e Deçanit në Rr. "Mareshal Tito", ishte blerë dhe shitur bashkë-pronarëve R(A)J dhe S(A)J.

Me parashtrësën e datës 23 Prill 2012, paditësja e ka ndryshuar padinë e saj duke kërkuar nga gjykata që të përcaktojë se ajo është pronare e pjesës ideale prej 1/2 të pasurisë së paluajtshme, ngastra kadastrale nr. 01161-0 e regjistruar në listën poseduese nr. 00246 Zona Kadastrale Decan, me kulturë bodrum+ objekt afarist + shtëpi private banimi e llojit bodrum +P+# si dhe oborr në një sipërfaqe të përgjithshme prej 0.5,89 m²; ngastra kadastrale nr. 00295-0 që ndodhet në Deçan në vendin e quajtur "Gogishte-Seishta" e një sipërfaqeje prej 0.17,70 m²; ngastra kadastrale me numër 00001-0 sipas listës poseduese. 00136 Zona Kadastrale Prilep në vendin e

quajtur “Gurina-Gërdaja” e një sipërfaqeje prej 6304 m2 dhe, ngastra kadastrale me numër 00002-0 në vendin e quajtur “Gurina-Gërdaja” më një sipërfaqe prej 12601 m2.

Paditësja po ashtu ka kërkuar nga gjykata që ta detyrojë të paditurin, përmes ndarjes fizike që të ia dorëzojë pjesët ideale të këtyre parcelave në posedim praktik të të paditurës dhe si kompensim material për pronën që i është shitur bashkë-pronarëve R(A)J dhe S(A)J, që të ia paguajë paditëses shumën prej 100.00€

Me aktvendimin e datës 11 Dhjetor 2012, lëshuar nga Nënkrjetari i Asamblesë së Gjyqtarëve të EULEX-it rasti është marrë përsipër në juridiksionin e Gjyqtarëve të EULEX-it dhe i është caktuar një Gjyqtareje për raste Civile të EULEX-it në Njësinë Mobile në nivel të gjykatave themelore sipas dispozitave të Ligjit Nr. 03/L-053 mbi Kompetencat, përzgjedhjen e lëndëve, caktimin e lëndëve të gjyqtarëve dhe prokurorëve të EULEX-it në Kosovë.

Me propozimin e palëve ndërgjygjëse në mënyrë që të përcaktohet gjendja faktike, gjykata ka nxjerrë dhe ka lexuar provat në vijim:

- Certifikatat e lindjes për MCL, ML, FL, FL dhe BL;
- Sfondi historik (origjinali: “Historiati”) lëshuar nga Drejtoria për Gjeodezi dhe Kadastër, e datës 5 Prill 2012;
- Certifikatë e lëshuar nga Agjencioni Kadastral i Kosovës me datë 27 Maj 2011 për parcelat nr. 295-00 dhe 1161-0 të dyja në Zonën Kadastrale Decan;
- Certifikatë e lëshuar nga Agjencioni Kadastral i Kosovës me datë 27 Maj 2011 për parcelat nr. 00001-00 dhe 00002-0 të dyja në Zonën Kadastrale Prilep;
- Aktgjykimi i Gjykatës Komonale në Pejë nr. 645/96 me datë 14 Gusht 1996;
- Kontrata mbi dhuratën me datë 14 Prill 2004 e lidhur në mes të HL në njërën anë dhe RAL, SAQ, DUS në anën tjetër;
- Kontrata mbi shpërbërjen e familjes e përpiluar me datë 30 Gusht 2004 në Decan mes palëve kontraktuese HBL dhe NBL të dy nga Decani e që janë djali dhe nëna;
- Kontrata mbi ndarjen e familjes me datë 27 Korrik 2006 e lidhur në mes të NL dhe HL;
- Sfondi historik (origjinali: “Historiati”) në lidhje me parcelat 295 dhe 1161 Zona Kadastrale Deçan, parcelat 1 dhe 2 Zona Kadastrale Prilep dhe parcelat 1701, 1702 dhe 1703 Zona Kadastrale Deçan me datë 3 Prill 2013;

- Dëgjimi i dëshmitarëve BHL, EAJ, DAJ, MAH, SML, RAL, BSK dhe IShM; dhe
- Dëgjimi i paditëses dhe i paditurit.

Duke vlerësuar secilën dhe çdo pjesë të provave veq e veq dhe si një tërësi, me ndërgjegje dhe me kujdes, sipas Nenit 8 të Ligjit mbi Procedurën Kontestimore (tash e mbas: LPK), gjykata vjen në konkludim se kërkesë padia do të aprovohet pjesërisht.

Gjatë procedurës së provave gjendja faktike në vijim është përcaktuar.

Paditësja dhe i padituri janë martuar me datë 12 Maj 1972. Gjatë kësaj martese, kishin lindur katër fëmijë: ML me 28 Qershor 1974, FL me 15 Janar 1976, FL me 15 Shkurt 1978, dhe BL me 10 Shtator 1979.

Martesa ka zgjatur deri me 14 Gusht të vitit 1996 kur ishte shpërbërë nga një aktgjykim i Gjykatës Komunale në Pejë nr. P 645/96.

Paditësja ka deklaruar në deklaratën e saj se kur ata janë martuar, ajo është shpërngulur në shtëpinë e të paditurit në Prilep. Familja ka jetuar në shtëpi së bashku me nënën e të paditurit dhe të katër motrat. Para luftës ata kanë filluar ndërtimin e një shtëpie të re në Decan dhe ajo e vjetra ishte djegur gjatë luftës.

Paditësja kujdesej për punët e përditshme të shtëpisë, duke rritur fëmijët, duke ndihmuar kunatat dhe vjehrrën dhe duke i kryer të gjitha punët tjera që i ka pasur; Ajo ka theksuar se ajo ishte trajtuar si një skllave. Ajo po ashtu ka punuar me vjehrrën dhe fëmijët në kopsht dhe në ara. Ndonjëherë ata kanë punësuar persona për të punuar.

Paditësja ka theksuar se i Padituri kishte shtëpi dy-katëshe me një kopsht të vogël kur ata janë martuar. Më pas, gjatë martesës, i Padituri kishte blerë nga një person IS tre parcela të cilat i ishin bashkuar kopshtit të tyre. I Padituri po ashtu kishte blerë një tokë në Prilep, një parcelë e cila quhet “Bonita”, dhe e vendosur pranë varrezave Serbe, ka qenë një kopsht. Dhe ai po ashtu ka blerë një shtëpi në të cilën ata kanë jetuar.

Paditësja ka konfirmuar se ajo kurrë nuk ka qenë e punësuar; ajo qëndronte në shtëpi gjersa i Padituri ka qenë i punësuar në Gjermani, Zvicër, dhe SHBA. I Padituri i ka ruajtur të ardhurat e

tija që ti blejë pronat ndërsa familja ka mbijetuar nga shitja e fasuleve dhe produkteve tjera bujqësore. Në mënyrë që ta mbajë familjen, paditësja ka bërë qilima në tezgjah të cilat i ka shitur së bashku me punimet tjera të dorës. Paditësja ka theksuar se i Padituri nuk i ka dhënë asaj para tjera për mbijetesën e familjes.

I Padituri ka konfirmuar në deklaratën e tij se paditësja është shpërngulur në shtëpinë e tij në Prilep kur ata janë martuar dhe kanë jetuar aty deri në vitin 1999.

Në lidhje me pasurinë e paluajtshme i Padituri ka konfirmuar si ai kishte trashëguar ca prona para martesës nga babai i tij i cili kishte vdekur me datë 17 Mars 1968. Gjatë martesës ai e kishte blerë pasurinë e paluajtshme afër Manastirit me parcelën nr. 295 nga MK në vitin 1982. Ai po ashtu ka blerë pronën ku është shtëpia e tij, me parcelën nr. 1161 nga ShM. Kjo blerje ishte bërë në vitin 1978 apo 1979. Përpos kësaj, po ashtu edhe parcelat nr. 1 dhe 2 në Prilep ishin blerë gjatë martesës; ai i kishte blerë ato nga SL.

Në lidhje me pronën që ndodhet në Deçan me numrat e ngastrave 1701, 1702 dhe 1703 i Padituri ka theksuar se ato parcela ishin regjistruar në emër të nënës së tij NL. Nëna e tij ia ka dhuruar atij parcelat në vitin 2004. I Padituri ka sqaruar se prona ka qenë në pronësi të nënës së tij dhe kur ai ka pasur nevojë për para në vitin 2004, nëna e tij e ka lejuar atë që ta shesë pronën në emër të saj. Ai i ka përdorur paratë për meremetimin e shtëpisë dhe kjo ka pasur qëllimin si dhuratë për të.

I Padituri po ashtu ka theksuar se ai është larguar dhe ka shkuar në Gjermani që të punojë me datë 14 Shtator 1968 dhe është kthyer me 27 Dhjetor 1979. Ai ka qëndruar atëherë disa vite në shtëpi; në vitin 1987 ai ka shkuar për 5 apo 6 muaj në SHBA.

Kur ai ka qëndruar në Gjermani ai udhëhiqte një kompani ndërtimi dhe ka fituar 3000 apo 4000 DM në muaj.

Ai ka theksuar se ai i ka shpenzuar paratë në blerjen e pasurisë së paluajtshme; kurdo që ai e ka pasur rastin për të blerë diçka, ai ka vepruar në atë mënyrë.

Sipas tij, ai i ka dhënë para gruas së tij-paditëses kurdo që ka pasur nevojë. Meqë ata kanë jetuar së bashku me nënë e tij dhe me motrat paratë janë dhënë për tërë familjen. Ai nuk i ka dhënë para paditëses çdo muaj por mendimi i tij është se ajo nuk ka pasur nevojë për to në baza mujore.

Ai ka theksuar se gjatë qëndrimit të tij në Gjermani; që ka zgjatur 11 vjet, ai e kishte vizituar familjen në Kosovë rreth 60 herë. Ai ka vozitur nga Gjermania në Kosovë; zakonisht ka qëndruar për 3 ose 4 ditë dhe asnjëherë nuk ka bërë vizita të gjata.

Gjykata po ashtu ka dëgjuar dëshmi nga dëshmitarët dhe ka konkluduar si në vijim.

Dëshmitari ISHM ka deklaruar se babai i tij ShM ia ka shitur një parcelë të paditurit, ku është shtëpia e të paditurit, para rreth 30 vitesh. Dëshmitari ka qenë në atë kohë 10 vjeç kështu që nuk mund të mbaj në mend ndonjë detaj tjetër në lidhje me atë blerje.

Dëshmitari BMK ka theksuar se babai i tij MK ia ka shitur të paditurit një pronë më poshtë Manastirit në vitin 1981.

Dëshmitari SL ka theksuar se ai ia ka shitur të paditurit pronën me parcelat 1 dhe 2, lista poseduese 136 Zona Kadastrale Prilep, që ndodhet në Gurina Gërdaja në vitin 1977.

Dëshmitari RL ka dhënë dëshmi se xhaxhai i tij ISL ia ka shitur të paditurit tokën në Prilep në vitin 1978.

Dëshmitari BL, i biri i palëve, ka theksuar se të dy parcelat ishin blerë nga RL dhe SL në Prizren. ai po ashtu ka theksuar se ai ka dëgjuar se toka ishte blerë në Decan nga babai i IM. Edhe një ngastër tjetër toke ishte blerë nga daja i tij HL; ajo gjendet 350 apo 400 metra nga Qendra e Deçanit në drejtim të Gjakovës. Dhe po ashtu nga MSL një copë toke, në certifikatë quhet Seishta, ishte blerë. Dëshmitari ka theksuar që ai ka qenë 6 ose 7 vjeç në atë kohë dhe ai kishte dëgjuar për këto blerje nga personat që kanë qenë të pranishëm aty.

Dëshmitarët DAJ, EAJ dhe MH kanë konfirmuar se fillimisht MH ka blerë pasuri të paluajtshme nga i Padituri në vitin 1990. Ka qenë një pronë e regjistruar në listën poseduese 604 Zona Kadastrale Decan me parcelat nr. 1701, 1702 dhe 1703. Çmimi i blerjes ka qenë 280.000 DM. Më vonë, në vitin 2011 kur bashkësia familjare u nda, EJ, DJ dhe MH qenë regjistruar si pronarë. Dëshmitari MH ka theksuar se ai ia ka dhënë paratë të paditurit.

Në mesin e dëshmime materiale të cilat ishin administruar gjatë shqyrtimit kryesor, gjykata konstaton si në vijim.

Nga certifikatat e lindjes gjykata përcakton se të katër fëmijët kanë lindur gjatë martesës; dhe ky fakt nuk është kontestuar mes palëve; ML e lindur me 28 Qershor 1974, FL e lindur me 15 Janar 1976, FL e lindur me 15 Shkurt 1978 dhe BL i lindur me 10 Shtator 1979.

Me aktgjykimin e Gjykatës Komunale në Pejë, C 645/96 me datë 14 Gusht 1996 martesë në mes të palëve ishte shpërbërë dhe ky fakt nuk ka qenë kontestues mes palëve.

Duke u bazuar në sfondin historik (në origjinal: “ Historiati”) me datë 03 Prill 2013, dhe lëshuar nga Drejtoria për Gjeodezi dhe Kadastër e Komunës së Deçanit, është konfirmuar se parcelat 295 dhe 1161 Zona Kadastrale Decan ishin regjistruar pas incizimeve ajrore në vitin 1983 në certifikatën nr. UL 70505021-00246; kjo do të thotë lista poseduese nr.246; në emër të HL.

Parcelat nr. 1701, 1702 dhe 1703 ishin regjistruar në certifikatën nr. UL 70505021-00604; kjo do të thotë lista poseduese nr. 604; në emër të NL dhe më vonë këto parcela ishin transferuar në emër të MAH.

Parcelat nr. 1 dhe 2 nga lista poseduese nr. 136 Zona Kadastrale Prilep; sipas incizimeve ajrore në vitin 1983, ishin regjistruar, dhe ende janë, në emër të HL.

Gjykata konstaton se Ligji Nr. 2004/32 Ligji për Familjen i Kosovës (në tekstin e mëtejshëm: Ligji i Familjes) do të zbatohet në kontestin aktual civil meqë padia është ngritur me 20 Korrik, 2011.

Në pajtim me Nenin 45 të Ligjit për Familjen prona e bashkëshortëve mund të jetë pasuri e veçantë ose e përbashkët. Në bazë të Nenit 46 paragrafit 2 i ligjit të njëjtë, prona e veçantë është gjithashtu një pronë e fituar gjatë martesës me anë të dhurimit, trashëgimit, apo formave të tjera të përvetësimit ligjor.

Në bazë të Nenit 47 paragrafi 1 i Ligjit të Familjes, pasuri e përbashkët e bashkëshortëve është pasuria e fituar me punë gjatë vazhdimit të martesës, si edhe të hyrat që rrjedhin nga pasuria e tillë. Sipas paragrafit 4 bashkëshortët janë pronarë të përbashkët në pjesë të barabarta të pasurisë së përbashkët nëse ndryshe nuk janë marrë vesh.

Për më tepër, në pajtim me Nenin 50 paragrafi 2 i Ligjit për Familjen, kur vetëm njëri prej bashkëshortëve regjistrohet si bartës i së drejtës pronësore për pasurinë e përbashkët në regjistrin e të drejtave në pasuri të patundshme, do të konsiderohet se regjistrimi është bërë në emër të dy bashkëshortëve. Prona nuk mund të tjetërsohet ose të administrohet pa pëlqimin e të dy bashkëshortëve, siç përcaktohet nga ligji i aplikueshëm.

Shpërndarja e pasurisë së përbashkët të bashkëshortëve mund të bëhet në çdo kohë me marrëveshje. Kur nuk arrihet marrëveshja, ajo do të vendoset nga gjykata ashtu siç është paraparë në Nenin 54 paragrafi 1 të Ligjit për Familjen.

Në bazë të Nenit 56 paragrafi 1 i të njëjtit ligj, ndarja e pasurisë së përbashkët të bashkëshortëve mund të kërkohet gjatë martesës dhe pas pushimit të saj.

Duhet për t'u theksuar se edhe Ligji i mëparshëm i Martesës dhe Familjes i Krahinës Socialiste Autonome të Kosovës (në tekstin e mëtejme: Ligji i Mëparshëm), e cila u aplikua nga 1 Shtatori 1984, përcaktuar në Nenin 307 që pasuria e fituar nga bashkëshortët, si rezultat i përpjekjeve të tyre të përbashkëta gjatë jetës së tyre së bashku, dhe të hyrat nga ajo pasuri është konsideruar si pasuri e përbashkët.

Në Nenin 310 paragrafi 2 i Ligjit mëparshëm, është e njëjta rregullore si në Ligjin për Familjen, kur në regjistrat e pasurisë së paluajtshme publike, vetëm njëri prej bashkëshortëve është i regjistruar si pronar i pasurisë së përbashkët; në atë rast, konsiderohet se regjistrimi është bërë në emër të të dy bashkëshortëve, në qoftë se regjistrimi nuk është kryer në një kontratë me shkrim të nënshkruar nga të dy bashkëshortët.

Në rast se ekziston një mosmarrëveshje në lidhje me atë se cila është pjesa e secilit bashkëshort në pasurinë e përbashkët, në pajtim me Nenin 310 paragrafi 1 i Ligjit të mëparshëm, pjesët janë përcaktuar sipas kontributit të tyre, duke marrë parasysh të gjitha rrethanat e aplikueshme; jo

vetëm të ardhurat e secilit bashkëshort por edhe ndihma e dhënë e njërit bashkëshort tjetrit, duke u kujdesur për fëmijët, detyrimet e menaxhimit të shtëpisë, kujdesin dhe mbrojtjen e pasurisë dhe të gjitha format e tjera të punës dhe të bashkëpunimit në mbrojtjen, administrimin dhe akumulimin e pasurisë së përbashkët.

Është përcaktuar në procedurën e provave, dhe ky fakt nuk është kontestues mes palëve, që martesë është bërë me 12 Maj 1972 dhe zgjati deri me 14 Gusht 1996. Gjatë martesës kanë lindur katër fëmijë; ML, FL, FL dhe BL.

Pasi ata kishin martuar, paditësja kishte kaluar në shtëpinë e të paditurit ku ajo ka jetuar së bashku me nënën e tij dhe të katër motrat.

I Padituri ka qenë duke punuar në Gjermani kur ata janë martuar dhe ai është kthyer me 27 Dhjetor 1979.

Andaj, kur fëmijët kishin lindur; ML me 28 Qershor 1974, FL me 15 Janar 1976, FL me 15 Shkurt 1978, dhe BL me 10 Shtator 1979, I Padituri ka qenë në Gjermani.

Paditësja ka qenë vetëm me fëmijët, me nënën e të paditurit dhe motrat. Ajo bindshëm ka sqaruar në deklaratën e saj se ajo është kujdesur për punët e përditshme të shtëpisë, duke rritur fëmijët, duke i ndihmuar kunatat dhe vjehrrën, duke i bërë të gjitha detyrat që kishte. Së bashku me vjehrrën, me fëmijët dhe ndonjëherë më persona që kishin marrë në punë, ajo e ka punuar kopshtin dhe arat. Ajo ka fituar para për mbijetesën e familjes nga shitja e fasuleve dhe produkteve të tjera bujqësore; Ajo ka punuar në tezgjah me duart e veta qilima të cilat i ka shitur së bashku me punëdore tjera të ndryshme.

Deklarata e paditëses është konfirmuar po ashtu edhe nga i Padituri. Kur është marrë në pyetje, se për çka i ka shpenzuar paratë e fituara në Gjermani, ai është përgjigjur se janë shpenzuar në pasuri të patundshme, kur ai kishte mundësinë për të blerë ca, ai ka vepruar ashtu.

Ne deklaratën e tij, I Padituri ka konfirmuar që ai u ka dhënë para të gjithëve në familje që kishin nevojë për to; duke përfshirë nënën e tij dhe motrat. Ai po ashtu i ka dhënë para edhe paditëses por jo në baza mujore sepse sipas tij, ajo nuk kishte nevojë meqë familja kishte ushqim dhe çdo gjë për të cilën ka pasur nevojë.

Bazuar në të gjitha këto fakte dhe rrethana, gjykata konstaton se kontributi i të dy palëve do të konsiderohet si i barabartë. I padituri kishte të ardhura të cilat janë të barabarta me kontributin e paditëses, gjersa ajo kujdesej për fëmijët, nënën dhe motrat e të paditurit, duke bërë punë të përditshme shtëpiake. Nga shitja e fasuleve dhe produkteve tjera të ndryshme bujqësore ajo kishte të hyra të cilat i ka shpenzuar për mbijetesën e familjes. Ajo kishte fituar të holla për mbijetesën e familjes gjithashtu edhe duke shitur qilima; të cilat i kishte thurur me tezgjah me duart e saja; dhe punime të ndryshme të dorës.

Një fakt që nuk duhet të neglizhohet është gjithashtu se I Padituri; ndërsa ai ishte në Gjermani për 11 vjet; në shtëpi vetëm rreth 60 herë, kjo do të thotë që ai e ka vizituar familjen çdo 2 muaj e gjysmë dhe secila vizitë ka zgjatur vetëm zgjati vetëm 3 ose 4 ditë duke përfshirë edhe udhëtimet.

Bazuar në këto fakte, përkujdesi ndaj fëmijëve, menaxhimi i detyrimeve të shtëpisë, kujdesi dhe mbrojtja e pasurisë së përbashkët, ishte detyrë dhe barrë e paditëses.

Sa i përket pasurisë së paluajtshme e cila është objekt i kësaj mosmarrëveshje, gjykata konsideron se këto në vijim janë blerë gjatë martesës:

- parcela nr. 01161 dhe 00295, lista poseduese nr. 00246 Zona Kadastrale Deçan;
- parcela nr. 00001 dhe 00002, lista poseduese nr. 00136 Zona Kadastrale Prilep.

Prona me ngastrën nr. 00295, lista poseduese nr. 00246 Zona Kadastrale Deçan, I Padituri e ka blerë nga MK.

Ky fakt që konfirmuar nga I Padituri i cili ka deklaruar se ai e ka blerë pronën e paluajtshme afër Manastirit, me numër të parcelës 295 nga MK në vitin 1982 dhe nga dëshmitari BMK i cili ka deklaruar se babai i tij MK ia ka shitur pronën të paditurit e cila ndodhet në pjesën e poshtme të Manastirit në vitin 1981.

Gjykata e konsideron vitin 1982 si të saktë pasi i padituri mori pjesë aktive si një blerës.

Pronën me ngastrën nr. 01161, lista poseduese nr. 00246 Zona Kadastrale Deçan, i padituri e ka blerë nga ShM.

Ky fakt u konfirmua nga i padituri i cili ka deklaruar se ai e bleu pronën e paluajtshme, ku shtëpia e tij është, me numër të ngastrës 1161 nga ShM në vitin 1978 apo 1979 dhe nga dëshmitari IShM i cili ka deklaruar se babai i tij ShM ia ka shitur një parcelë, ku ndodhet shtëpia e të paditurit rreth 30 vjet më parë.

Prona me ngastrën nr. 00001 dhe nr. 00002, të dyja të regjistruara në listën poseduese nr. 00136 Zona Kadastrale Prilep, i padituri e ka blerë nga SL.

Ky fakt u konfirmua nga i padituri i cili ka deklaruar se ai e bleu gjatë martesës edhe parcelat me nr. 1 dhe 2 në Prilep nga SL. Si një dëshmitar, dha dëshmi edhe SL i cili ka deklaruar se ai ia ka shitur të paditurit parcelat 1 dhe 2 nga Lista Poseduese 136 Zona Kadastrale Prilep, e vendosur në Gurina Gërdaja, në vitin 1977.

Të gjitha transaksionet e mësipërme janë bërë para regjistrimeve ajrore në vitin 1983 dhe për këtë arsye janë regjistruar pas vitit 1983 në emër të të paditurit.

Në bazë të nenit 47 paragrafi 1 i Ligjit për Familjen parcelat nr. 01161 dhe 00295, lista poseduese nr. 00246 Zona Kadastrale Deçan dhe parcelat nr. 00001 dhe 00002, lista poseduese nr. 00136 Zona Kadastrale Prilep do të konsiderohen si pronë e përbashkët e të dyja palëve, që ishin fituar me punën e të dyja palëve gjatë rrjedhës së martesës. Dhe sipas paragrafit 4 të të njëjtit nen palët janë pronarë të përbashkët në pjesë të barabarta të pasurisë së përbashkët.

Nga e gjithë gjendja faktike e përcaktuar si më lartë dhe bazat ligjore gjykata vendosi për aprovimin e padisë dhe duke konfirmuar se paditësja është pronare e pjesës ideale prej ½ e pasurisë së paluajtshme me parcelat nr. 01161 dhe 00295, lista poseduese nr. 00246 Zona Kadastrale Deçan dhe parcelat nr. 00001 dhe 00002, lista poseduese nr. 00136 Zona Kadastrale Prilep.

Sa i përket pasurisë së paluajtshme me numër të ngastrave 1701, 1702 dhe 1703, lista poseduese 00604 Zona Kadastrale Deçan gjykata konstaton se pronari i kësaj prone ishte nëna e të paditurit NL dhe jo i padituri.

Ky fakt qe po ashtu konfirmuar në Sfondin Historik (në origjinal: “Historiati”) lëshuar nga Drejtoria për Gjeodezi dhe Kadastër e Komunës së Deçanit me datë 3 Prill 2013.

I padituri ka deklaruar bindshëm se nëna e tij ia ka dhuruar atij parcelat në vitin 2004, kur ai kishte nevojë për të holla dhe ajo e lejoi atë të shesë pronën në emër të saj. Gjykata nuk ka pasur dyshime, kur ai deklaroi se paratë e marra nga shitja ishin menduar si një dhuratë ndaj tij.

Në bazë të Nenit 46 paragrafi 2 i Ligjit mbi Familjen pasuria e fituar gjatë martesës me anë të dhurimit, trashëgimit, apo formave të tjera të përvetësimit ligjor do të konsiderohet si pronë më vete.

Dispozitë e ngjashme është po ashtu edhe Neni 306 paragrafi 2 i Ligjit të mëparshëm, i cili konsideron si pasuri të shquar (pasuri e veçantë) pasurinë e fituar gjatë martesës me anë të dhuratave, trashëgimit apo përfitimet tjera pa taksa.

Bazuar në gjendjen e përcaktuar më sipër faktike dhe bazat ligjore, gjykata refuzon kërkesën e paditëses për të detyruar të paditurin që t'i paguajë shumën prej 100.000 euro paditëses si kompensim material për pronën e shitur bashkë-pronarëve R(A)J dhe S(A)J.

Në fakt kjo pronë i ishte shitur MH, por ky fakt nuk ishte vendimtar kur të merren parasysh faktet të cilat janë thelbësore.

Fakt thelbësor është se kjo pronë nuk ka qenë asnjëherë në pronësi të paditësit dhe se paratë e marra nga shitja kanë qenë dhuratë nga nëna e tij dhe do të konsiderohet si pronë më vete.

Gjykata hedh poshtë edhe pretendimin në pjesën ku paditësja ka kërkuar të detyrojnë të paditurin, nëpërmjet ndarjes fizike, për dorëzimin e pjesëve ideale të parcelave 01.161 dhe 00.295, lista poseduese nr. 00246 Zona Kadastrale Deçan, dhe parcelat nr. 00001 dhe 00002, lista poseduese nr. 00136 Zona Kadastrale Prilep, në posedim praktik të paditëses.

Ndarja fizike (ndarja) e pasurive të patundshme në bashkëpronësi është e rregulluar nga Ligji nr. 03/L-007 mbi procedurën jokontestimore.

Një pretendim i tillë për ndarje fizike, do të depozitohet në përputhje me dispozitat e Nenit 197 të ligjit të sipërpërmendur dhe nuk mund të jetë objekt i kësaj procedure kontestimore.

Nga të gjitha që u thanë më lartë, gjykata vendosi sikurse në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Në pajtim me Nenin 452 paragrafi 3 të LPK-së gjykata vendos se i padituri do të reimbursejë shpenzimet e bëra të paditëses. Paditësja e ka humbur një pjesë të padisë, por pavarësisht nga kjo gjykata konstaton se për këtë pjesë nuk ka shpenzime shtesë të përlllogaritura. Në rast se paditësja do kishte parashtruar padi vetëm në pjesën e cila është aprovuar, shuma e njëjtë e shpenzimeve do të paraqitej.

Në seancën kryesore të mbajtur më 20 Maj 2013, i padituri përmes avokatit të tij ka kërkuar reimburseimin e kostove të tij. Në pajtim me Nenin 463 paragrafi 2 i LPK-së gjykata e ka udhëzuar atë që të i specifikojë kostot brenda 3 ditëve. Meqë gjykata nuk e ka marrë specifikim deri tani, do të konsiderohet se i padituri nuk ka kërkuar reimburseimin e kostove.

Gjatë vlerësimit të shpenzimeve, sipas Nenit 453, paragrafët 1 dhe 2 të LPK-së, gjykata i ka konsideruar të gjitha rrethanat dhe ka vendosur se kërkesa e parashtruar nga përfaqësuesi i paditëses në shumë prej 970, 32 EUR, është e bazuar.

Kjo shumë përbëhet nga 78 Euro për hartimin e kërkesës, 486,72 euro për 4 seanca (121,68 euro për secilën) dhe 405,60 Euro për 2 seanca paraprake dhe 2 seanca kryesore (101,40 euro për secilën).

Këshillë juridike:

Palët mund të paraqesin ankesë kundër këtij aktgjykimi në Gjykatën e Apelit përmes Gjykatës Themelore të Pejës/ Dega Deçan brenda pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga dita e dorëzimit të kopjes së aktgjykimit palëve.

Gjykata Themelore Pejë

Dega Deçan

C. nr. 250/11

20 Maj 2013

Përpiluar në gjuhën Angleze,
si gjuhë zyrtare.

Kryetare e trupit gjykues

Franciska Fiser